Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

### 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;

*c. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 5/1;*

*ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;*

*d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

*dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

### **2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve (2017,2018), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet .

2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 2 (dy) viteve (2018,2019) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se fondi limit dhe konkretisht 7 780,500(shtatë milion e shtatëqind e tetëdhjetë mijë presje pesëqind ) lekë pa tvsh.

3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019.

3.1. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR.

### **2.3 Për kapacitetin teknik:**

#### **Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

Furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 3,112, 200(tre milion e njëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind) lekë pa tvsh të realizuar gjatë tri viteve të fundit(përlllogaritur nga data e zhvillimit të tenderi)

#### **Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërpërmendur operatori Ekonomik duhet të paraqesë:**

Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate.

Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur faturat tatimore te shitjes të nënshkruar nga të dyja palët ku te shenohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

**2.4.** Operatori ekonomik duhet te paraqesë Certifikaten e Cilësisë **ISO 9001- 2015** (e vlefshme),leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim.

Certifikata kerkohet te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, operatori ekonomik duhet te dorezoje certifikaten ISO sipas zerave që do te marre persiper sipas akt-marreveshjes.)

**2.5** Shoqeria duhet te paraqesë Certifikaten e Sigurisë së Informacionit **ISO 270001** (e vlefshme), apo e standartit të përditësuar .(Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikaten ISO sipas zerave te shërbimeve që do te marre

persiper sipas akt-marreveshjes.)

**2.6.**Operatori ekonomik duhet te paraqese:

- Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, për objektin e prokurimit për mallin e kërkuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**2.7.** Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese në sistemin elektronik katalogun/et/datasheet të prodhuesit/ve te mallrave objekt prokurimi. Në rast se katalogjet apo broshurat janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe sipas legjislacionit në fuqi.

**2.8.**Operatori ekonomik duhet të paraqesë nga 1 (një) mostër të mallrave objekt prokurimi. Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim.

**2.9.**Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi jo më pak se 2 (dy) punonjës inxhinierë/specialistë të fushës IT (elektronikë/,teknologji informacioni/,inxhinieri telekomunikacioni/informatikë ekonomike/informatike/inxhinieri informatike).

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- List pagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Shkurt 2020- Prill 2020.**
- Diplomat përkatëse të specialistëve

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## **Shtojca 9**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

**Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në**

mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

## **1. Përshkrimi dhe karakteristikat teknike te sistemit**

**Ky aplikacion duhet te funksionojë ne PDA me sistemin Android v4.4.3 e siper dhe te jete me nderfaqe ne gjuhen shqipe.**

Aplikacioni per PDA duhet te nderveproje me sistemin qendro te administrimit nepermjet teknologjivete eeb sherbimeve ne standartin SOAP.

### 1.1 Siguria e aksesimit

Sistemi duhet te ofroje siguri ne akses duke implementuar politika te konfigurueshme per rregullat mbi kredencialet e autentifikimit. Ketu mund te permendim:

- skadencen e konfigurueshmetekredencialeve,
- vendosjen e detyrimeve per ndryshimin periodik te kredencialeve nga perdoruesit,
- vendosjen e detyrimeve ndaj perdoruesve per rritjen e fortesise se kredencialeve duke perdorur karaktere special.

Sistemi duhet te ekspozojë ne menyre te detajuar te gjitha funksionalitetet e tij ne trajten e te drejtave te perdorimit. Administratoret e sistemit duhet te mund te krijojne role me te drejta, te percaktuara qarte dhe te detajuara.

Sistemi duhet te lejojë lidhjen e kredencialeve te aksesit me adresen IP te kompjuterit te perdoruesit. Ne kete menyre garantohet qe perdorues te tjere nuk mund te perdorin sistemin duke perdorur kredencialet e nje perdoruesi tjetër.

### 1.2 Ruajtja e historikut te ndryshimeve

Sistemi duhet te ruaje historik te detajuar per ndryshimet qe behen mbi entitetet. Ne cdo moment administratoret e sistemit duhet te mund te shikojne te dhena mbi vleren e vjeter, vleren e re, perdoruesin dhe oren e sakte kur eshte kryer modifikimi.

### 1.3 Procedurat e Back Up

Sistemi duhet te garantojë procedura te qarta per Back Up periodik te te dhenave. Te dhenat duhet te kopjohen ne server te ndryshem fizikisht nga server ku eshte instaluar sistemi.

### 1.4 Qendrueshmeria e Sistemit



Sistemi duhet të ofrojë qëndrueshmëri të lartë duke përdorur arkitekturë të shpërndarjes së ngarkesës së përpunimit (load-balancing) për të minimizuar kohën e mungesës së shërbimit (doëntime)

### 1.5 Zgjerueshmëria e Sistemit

Sistemi duhet të ngrihet mbi një arkitekturë të mirëmenduar për të lehtësuar shkallëzimin e biznesit në rastin e rritjes së numrit të transaksioneve dhe volumit të të dhënave që ngarkohen në sistem. Minimalisht sistemi duhet të integrohet me sistemin aktual të faturimit që përdor institucioni.

### 1.6 Optimizimi i përdorimit të bandës

Sistemi duhet të përdorë teknika për optimizimin e përdorimit të bandës në të gjitha nivelet.

### 1.7 Mbrojtja e sistemit nga sulmet kibernetike

Sistemi duhet të sigurojë mbrojtje nga sulmet kibernetike. Menyra sesi sistemi e arrin këtë duhet të jepet e shpjeguar paraprakisht në ofertën e dërguar

### 1.8 Politika për shfrytëzimin e kodit burimor, arkitekturë e sistemit

Arkitekturë e sistemi duhet të jetë e shtresëzuar dhe kodi duhet të jetë i organizuar në klasa të ripërdorshme për të thjeshtuar zgjerimet/modifikimet e ardhshme. Sistemi duhet të jetë i gatshëm për integrim me sisteme të paleve të treta me anë të ëb shërbimeve. Ëb shërbimet duhet të garantojnë aksesimin e sigurtë duke përdorur kredenciale autentikimi dhe OTP (one time passëord).

### 1.9 Versionimi dhe aplikimi i modifikimeve

Kodi burimor i sistemit duhet të ruhet në një sistem versionimi GIT/SVN/CVS etj. Aplikimi i shtimeve apo modifikimeve të funksionaliteteve duhet të bëhet sipas procedurave operative të mirëpërcaktuara të cilat duhet të përfshijnë plane për rikthimin në gjendjen e mëparshme të sistemit në rast deshtimi.

### 1.10 Manuali përdorimit dhe dokumentacioni teknik

Sistemi duhet të shoqërohet me manual përdorimi në gjuhën shqipe dhe të shpjegojë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme të gjitha funksionalitetet e ofruara. Sistemi duhet të shoqërohet me dokumentacion teknik në gjuhën shqipe. Në rast të shtimit apo modifikimit të funksionaliteteve dokumentacioni përkatës duhet të përditesohet.

1.11 Gjuha e sistemit. Sistemi i administrimit dhe sistemi që do të përdoret nga pajisjet mobile duhet të jetë teresisht në gjuhën shqipe.

## 2. Karakteristika te vecanta funksionale

Me poshte vijon specifikimi i karakteristikave te vecanta qe duhet te plotesoje sistemi i propozuar ne menyre te tille qe te realizoje funksionet aktuale por gjithashtu te sjelle permiresime te ndjeshme. Funksionalitetet paraqiten te ndara sipas pjeseve perberese te sistemit.

### 2.1 Karakteristika funksionale te pjeses se administrimit

Nderfaqja e administrimit eshte paneli i kontrollit per te gjithë sistemin. Ne kete nderfaqe perdoruesit menaxhojne te gjitha te dhenat te cilat akumulohen nga leximet ne terren, marin raporte operacionale dhe gjithashtu raporte te ndryshme per leximet dhe raporte te tjera te nevojshme per mireorganizimin e punes. Nderfaqja e administrimit duhet te jete e thjeshte dhe intuitive per te perdorur ne menyre te tille qe te minimizojë kohen e nevojshme per ambjentimin e perdoruesve me te.

2.2 Gjate hedhjes se leximeve per abonentet sistemi duhet te mundesojë shtimin e problematikave ne nivel te palimituar nenkategorish. Ky informacion duhet te sherbeje per te ndertuar raporte te detajuar per te percaktuar sakte problemet qe kane abonentet dhe veshtiresite qe kane lexuesit gjate punes se tyre.

2.3 Sistemi duhet te mundesojë krijimin e ndarjes hierarkike zonale duke lejuar keshtu copezimin e zonave ne nen-zona me te menaxhueshme.

2.4 Sistemi duhet te ofrojë mundesi per shtimin e nyjeve teknike ne menyre hierarkike. Tipologjia e nyjeve teknike duhet te jete dinamike per te mundesuar shtimin e metejshem. Per nyjet teknike duhet te ruhet edhe statusi ne te cilin ndodhet. Status i nyjes sherben psh: per te pare impaktin ne rast te riparimeve te ndryshme apo edhe per te gjeneruar njoftime automatike ne te ardhmen.

2.5 Sistemi duhet te jape mundesine per krijimin e sistemit te adresave hierarkike ne trajten e vendodhjeve. Sistemi i adresimit duhet te filloje nga ndarja administrative me e madhe rreth me tej bashki e komune. Cdo vendodhje lidhet me zonen e sherbimit te ciles i perket, me nyjen teknike furnizuese dhe gjithashtu me pozicionin gjeografik ne harte.

2.6 Sistemi duhet te mundesojë caktimin e zonave lexuesve. Sistemi duhet te njoftojë ne nje zone i eshte caktuar mepare nje lexuesi tjeter ne menyre te tille qe te behet perdorimi me eficence i burimeve njerezore.

2.7 Sistemi duhet te mundesojë percaktimin e itinerarit te leximeve per secilin lexues ne menyre kalendarike per cdo dite. Sistemi duhet te sigurojë shperndarjen e lexuesve ne menyre te tille qe mos kete perpasje ndermjet tyre, nuk mund ti caktohet 2 lexuesve te njejtet abonente.

2.8 Sistemi duhet te sinkronizohet me te dhenat e sistemit te aktual te faturimit. Disa nga te dhenat qe sinkronizohen me sistemin e faturimit jane:

2.9

- Te dhenat per abonentet

- Te dhenat per anomalite
- Te dhenat per zonat

Procesi I sinkronizimit duhet te jete automatik dhe real time. Sistemi duhet te realizoje kalim e te dhenave te marra nga lexuesit ne menyre autmatike ne sistemin e faturimit.

### **3. Karakteristika funksionale te aplikacionit per lexuesit ne terren**

Pjesa e nderveprimit midis aplikacionit per PDA dhe nderfaqes se administrimit duhet te jete parashikuar e pavarur, e bazuar ne teknologjite e ëeb sherbimeve. Ne kete menyre ne te ardhmen aplikacioni per PDA mund te zevendesohet me aplikacion per pajisje te tjera me sisteme operimi te ndryshme.

3.1 Aplikacioni per PDA-te duhet te jete i thjeshte dhe intuitiv ne perdorim dhe te ofroje nje nderfaqe e cila punon shpejte per te lehtesuar punen e lexuesve.

3.2 Aplikacioni per PDA duhet te dergoje te dhena per vendodhje gjeografike te lexuesit ne momentin e marjes se leximit. Te dhenat gjeografike duhet te dergohen me nje precision sa me te larte.

3.3 Aplikacioni mbeshtetes per marjen e pozicionit gjeografik duhet te parashikojte situatat kur lexuesit gjenden ne zona pa mbulim nga satelitet si psh: brendesia e godinave etj. Ne kete rast aplikacioni mbeshtetes duhet te raportoje vendodhjen e fundit te sakte qe ka percaktuar nga sinjali GPS.

3.4 Aplikacioni per PDA komunikon me aplikacionin mbeshtetes te marjes se pozicionit gjeografik nepermjet tekines inter-process communication. Ne kete menyre komunikimi eshte i sigurte dhe i shpejte.

3.5 Aplikacioni per PDA duhet te ofroje mundesine e sinkronizimit te mevonshem por gjithashtu duhet te sinkronizojte te dhenat ne kohe reale ne rastet kur gjendet ne zonat me mbulim te sinjalit celular.

3.6 Aplikacioni per PDA duhet te kerkoje berjen e fotografive ne cdo rast ose bazuar mbi logjiken e percaktuar nga administratori i sistemit.

3.7 Aplikacioni per PDA duhet ti shfaqe lexuesit ne menyre te qarte itenerarin e planifikuar nga menaxheret e tyre nepermjet nderfaqes se administrimit.

3.8 Aplikacioni per PDA duhet te perdore teknikat e kompresimit te informacionit per dergimin e te dhenave ne serverin qendror duke perdorur sa me pak banden e internetit.

3.9 Aplikacioni per PDA duhet te perdore teknika te verifikimit te dergimit te sakte te dhenave ne server dhe duhet gjithashtu te perdore teknika te menaxhimit te deshtimit te lidhjes me server apo te nderprerjes se dergimit te te dhenave.

3.10 Aplikacioni per PDA duhet te perdore teknika per kriptimin e te dhenave te cilat dergon ne

server duke parandaluar kështu interceptimin e tyre nga persona keqdashës.

#### 4. Nderveprimi midis pjeseve perberese

Nderfaqja e administrimit duhet te ofroje mundesi per inventarizimi e pajisjeve PDA duke lejuar regjistrimin e informacioneve shtese per cdo pajisje si psh: status i pajisjes, personi i cili e ka ne dorezim pajisjen, version i aplikacionit te instaluar ne PDA etj.

Nderfaqja e administrimit duhet te mundesoje shfaqjen e fotografive te ngarkuara ne sistem nga aplikacioni per PDA.

Per cdo leximi te raportuar ne sistem ne nderfaqen e administrimit duhet te jepet mundesia e paraqitjes ne harte te pozicionit te lexuesit ne momentin e leximit.

Nderfaqja e administrimit duhet te ofroje reporte per nxjerrjen e variacionit te distances nga abonenti ne momentin e leximit te matesit.

Nderfaqja e administrimit duhet te mundesoje shfaqjen ne harte te itinerarit te nje lexuesi ne nje segment kohor te caktuar.

Perverc reporteve te gatshme, nderfaqja e administrimit duhet te mundesoje krijimin e reporteve ne moment nga perdoruesit e sistemit me ane te veprimeve te dhjeshta ‘drag and drop’.

Nderfaqja duhet te ofroje panele me informacion te shpejte ne trajten e grafikeve te llojeve te ndryshme per perdoruesit e roleve te ndryshme.

Informacioni per gjenerimin e grafikeve duhet te ekspozohet ne trajten e ëeb sherbimeve REST ne menyre te tille qe ne ardhmen keto te dhena te perdoren per gjenerimin e grafikeve ne aplikacion per smartphone per tu dhene menaxhereve te niveleve te larta informacion te shpejte ku do qe ata ndodhen.

Sherbimi mbeshtetes per sinkronizimin e te dhenave duhet te perdore teknika te menaxhimit te situatave te konkurences per te evituar rastet e bllokimit te ndersjellte (deadlocks).

Aplikacioni android duhet te mund te realizoje perditesimin e vetes nepermjet internetit pa perdorur sherbimet e Google Play.

Aplikacioni duhet te ruaje log-e te aktivitetit te perdoruesit dhe duhet te mund ti dergoje keto ne server ne momentin e dergimit te kerkeses nga server.

Aplikacioni android duhet te implementoje mesazhet push te cilat mundesojne kryerjen e nje sere aktivitetesh ne PDA pa nevojën qe perdoruesi te kryejë ndonjë veprim. Ky funksionalitet lehtëson administrimin nga stafi qendror i IT te UKT dhe shmang lexuesin nga njohja me funksionalitetet teknike. Aplikacioni android duhet te mund te ndryshojë oren dhe datën e sistemit lokal duke bërë të mundur sinkronizimin e ores dhe dates me oren dhe datën e server qendror.

Shënim: Implementimi i softëare-it dhe liçensave përkatëse në secilën PDA do të kryhet nga stafi teknik i operatorit kontraktues.

#### *Specifikimet teknike te pajisjes PDA*

<b>KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE</b>	
Procesor	Min 1.5GHz Quad-core processor
Memoria	Min 4 GB RAM, Min 32GB Storage
Ekrani	LCD, 5-Inch

## Dokumentat Standarde të Tenderit

Kamera	Para: min 8 MP Mbrapa: min 16 MP
Bateria	Min 4700mAh
Rrjeti	3G: ĒCDMA 2100/1900/1700/850/900 4G: FDD-LTE 2100/1900/1800/1700/850/2600/900/700/700/800 4G: TDD-LTE 2500/1900/2300/2500
Sensore	G-sensor, P-Sensor, L-sensor, Gyro, Electronic Compass, Touch Sensor, barometric sensor, NFC
Ekstra	Certifikuar IP68, i qëndrueshëm ndaj ujit dhe i papërshkueshëm nga pluhuri në bazë të vlerësimit IP69K/IP68
Bluetooth	Bluetooth 4.1
Sistemi	Android min 7
GPS	Po
Garancia	1 Vit

**Karakteristikat e mesiperme per produktet jane ato minimale. AK do te pranoje çdo paisje te cilat do te jene te nje standarti me te larte se ai i specifikuar.**

### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

**Shtojca 10**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

**SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT**

Sasia e mallit që kërkohet:

<b>Nr</b>	<b>Pershkrimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>
1	Telefona/PAD	cope	130
2	Licensa per softëare lexim matje faturimi- Al-Billing AMS Mob 4.4.4	licensa	26

Afatet e lëvrimit: 20 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës

**Shtojca 11**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër* ]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>		
<b>02</b>		
<b>03</b>		
<b>...</b>		

**Shtojca 12**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>1</sup>**

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< **Emri** >



**Shtojca 13**

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

## Dokumentat Standarde të Tenderit

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Dokumentat Standarde të Tenderit

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 15

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokurara me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifrat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

## Dokumentat Standarde të Tenderit

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikrat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

#### **Neni 6: Pronësia Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Mallrave**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nënkontraktuesit që siguron mallrat.

### **Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet**

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

### **Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike**

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimit e reklamës së shitesit (Kontraktuesit).

### **Neni 10: Pjesët e Këmbimit**

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvuara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozite përkatëse të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.



- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japë pa pagesë Autoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

#### **Neni 11: Ambalazhimi**

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe paketuar në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë vendosur dhe paketuar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, nëse mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

#### **Neni 12: Testimet dhe Inspektimet**

- 12.1 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës
- 12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.
